



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-43
5.2.2026
Shkup

Në bazë të nenit 13, paragrafi (3), nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 82, paragrafi (1), nënparagrafët 2 dhe 5 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25) dhe në lidhje me nenin 62, paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, nenit 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i konsoliduar) nr. ark. 01-3953/1 datë 31.10.2023, nenit 51, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe nenit 52, paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr. 08-20 datë 20.1.2026 për iniciim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr. 08-43 datë 2.2.2026 për miratim të vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, në pajtim me Konkluzionin, nr. ark. 02-418/5 datë 3.2.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 5-të mbajtur më 3.2.2026, miratoi:

VENDIM
për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-141 datë 18.3.2019, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht sepse radiodifuzeri nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadroviqe të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe për shkak se zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose të tjera.

2. Ky Vendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-141 datë 18.3.2019, për

transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resor (burim) të kufizuar, në nivel shtetëror, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm në të cilat llojet e programeve të përfaqësuar përbushin tre funksione mediatike, në gjuhën maqedonase.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVIZIJA SONCE SHPKNJ P Prilep, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr. 08-141 datë 18.3.2019, për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resor (burim) të kufizuar, në nivel shtetëror, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm në të cilat llojet e programeve që përfaqësojnë realizojnë tre funksione mediatike, në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 62, paragrafi (6) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), për sigurim të transmetimit televiziv, përveç kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, transmetuesi duhet të përmbushë kushte të veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe në varësi të formatit programor, të përcaktuara me akte nënligjor të miratuar nga Agjencia.

Neni 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, përcakton se zotëruesi i lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune të ketë së paku 20 (njëzet) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse posedon leje për transmetim të programit në nivel shtetëror, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resor të kufizuar ose nëpërmjet satelitit, dhe se kryeredaktori i shërbimit programor me format të përgjithshëm dhe të specializuar, duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Në pajtim me nenin 27, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, e cila kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin e Mediave, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit (neni 29, paragrafi 1 të LShMAAV).

Në nenin 27, paragrafi (4) të LShMAAV, është përcaktuar se Agjencia kryen mbikëqyrje të jashtëzakonshme, në bazë të iniciativës së paraqitur nga organet shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Më 1.12.2025, drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) u dorëzua Njoftim me (nr. ynë ark. 08-5192/1) se transmetuesi gjendet para hapjes së procedurës së falimentimit dhe nga data 1.12.2025, asnjë punonjës nuk kishte kontratë pune të vlefshme.

Pastaj, më 4.12.2025, drejtuar Agjencisë u dorëzua Vendim nga pronari i ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, për ndërprerjen e shoqërisë nëpërmjet falimentimit nr. 0101/177/1 datë 18.11.2025 me (nr. ynë ark. 08-5192/2 datë 4.12.2025).

Agjencia gjatë një kontrolli të rregullt të të dhënave të publikuara në sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV), konstatoi se më datë 4.12.2025, në ueb faqen e RQRMV-së është publikuar aktvendimi Fq. nr.125/25 datë 2.12.2025 të Gjykatës Themelore Prilep për inicim të procedurës paraprake për përcaktimin e shkaqeve për hapjen e procedurës së falimentimit kundër debitorit ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Gjithashtu, gjatë kontrolli të rregullt të publikimeve në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia konstatoi se aktvendimi i cituar i Gjykatës Themelore në Prilep është publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr. 250 datë 12.12.2025.

I. Në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme nga aspekti i dispozitave të LSHMAAV, dhe me qëllim të verifikimit nëse ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, në pajtim me nenin 62, paragrafi (6) të LSHMAAV, i përmbush dhe kushtet minimale kuadroviqe të përcaktuara në rregulloren e lartpërmendur, më 10.12.2025, Agjencia me Kërkesë nr. ark. 03-5318/1, kërkoi nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë

së Veriut (APRMV) të ofrojë të dhëna për numrin e të punësuarve në ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Më 17.12.2025, APRMV-së njoftoni Agjencinë se në pajtim me evidencën e APRMV-së të personave të regjistruar si të papunë dhe regjistrim/çregjistrim/nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, për personin juridik ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, numrin e të punësuarve më 11.12.2025, është 1, dhe më 30.11.2025 është 19.

Më 15.1.2026, Agjencia nga APRMV-së siguroi të dhëna më të reja për numrin e të punësuarve tek transmetuesi, sipas të cilit, në pajtim me evidencën e regjistrimeve/çregjistrimeve të regjistruara nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm paraqitur në APRMV-së, përfshirë dhe momentin e dhënies së certifikatës, numrin e punonjësve të transmetuesit më 15.12.2025 është 1, dhe më 15.1.2026 është 1.

Në lidhje me njoftimin nga APRMV-së, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, (SPSDA), më 15.1.2026, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative sipas detyrës zyrtare, të punës së ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, me ç'rast në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. ynë ark. 03-225/1 datë 15.1.2026, konstatoi se transmetuesi në fjalë nuk i përmbush kushtet minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

II. Gjithashtu, Sektori i mbështetjes informatike dhe i çështjeve të përgjithshme (SMIÇP) në Agjenci, më 24.12.2025, drejtorit të Agjencisë i dorëzoi Shënim zyrtar nr. ark. 03-5570/1, se gjatë kontrollit të rregullt të sistemit për regjistrim dhe monitorim të shërbimeve televizive dhe radio më 23.12.2025, si dhe nga njohuritë e marra ka konstatuar se ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep nuk transmeton program televiziv, përkatësisht se transmetuesi ka ndërprerë transmetimin më 10.12.2025 në orën 12:00. Në Shënimin zyrtar, thuhet se SMIÇP do të kryej monitorim, me qëllim për të përcaktuar nëse zotëruesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera.

Monitorimi u realizuara në periudhën nga 10.12.2025 deri më 15.1.2026. Nga monitorimi i kryer u konstatua se ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep nuk punon në pajtim me LShMAAV, përkatësisht më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me sa më sipër, SMIÇP drejtorit të Agjencisë i dorëzoi Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (nr. ark. 03-254/1 datë 20.1.2026) të kryer më 16.1.2026, të jashtëzakonshëm, të realizuar me rastin e Shënit zyrtar nr. ark. 03-5570/1 datë 24.12.2025, me ç'rast mbikëqyrja mbuloi periudhën nga 10.12.2025 deri më 15.1.2026. Në raportin me shkrim të cituar, thuhet se nga mbikëqyrja u konstatua se ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë.

III. Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LShMAAV, u përcaktua se nëse konstatohet mos respektim, cenim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë, kundër botuesit të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndërmarrë masë – për heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) nënparagrafët 2 dhe 5 të LShMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, pas njoftimit paraprak me shkrim, nëse zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera (neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 2), si dhe nëse pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë (neni 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5).

Procedura për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LShMAAV, inicohet nga Këshilli me propozim të Drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e përcaktuar të fakteve, drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 83 paragrafët (1) dhe (2) të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 82, paragrafi (1) nënparagrafët 2 dhe 5 nga Ligji i njëjtë, Këshilli të Agjencisë i dorëzoi Propozimin PA1 nr. 08-20 datë 20.01.2026 për inicim të procedurës për heqjen e lejes të ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Në lidhje me Propozimin e cituar më sipër, në pajtim ku transmetuesi nuk përmbushur kushtet minimale kuadrovice të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (neni 62 paragrafi 6 të LSHMAAV dhe neni 21 të Rregullores së njëjtë) ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera (neni 82, paragrafi 1 nënparagrafi 5 të LShMAAV), Këshilli i Agjencisë në seancën e 3-të mbajtur më 21.1.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr. ark. 02-253/2 datë 21.1.2026, inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Agjencia, në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) të LShMAAV ndaj ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, dërgoi Njoftim (PA1 nr. 08-20 datë 22.1.2026), se në bazë të nenit 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes, të shkeljes në fjalë të LShMAAV dhe Rregullores së cituar, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim.

Njoftimin PA1 nr. 08-20 datë 22.1.2026 iu dorëzua me shkrim SHTR TELEVIZIJA SONCE SHPKNJ P Prilep dhe menaxheres së autorizuar të falimentimit - Emilija Koteska. Në Agjenci u dorëzua përgjigje nga Posta e Maqedonisë ku thuhet se shkresat u pranuan në mënyrë të rregullt më 26.1.2026. Gjithashtu njoftimi më 26.1.2026 u dërgua në formë elektronike dhe menaxheres së autorizuar të falimentimit, e cila të njëjtën ditë dërgoi konfirmim se njoftimi u pranuar nga ana e saj.

Ndërkohë, më 28.1.2026, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.15/26 u publikua se Gjykata Themelore në Prilep, pas zbatimit të procedurës paraprake dhe seancës së mbajtur në prezencë të menaxheres së përkohshme të falimentimit Emilija Koteska, me Aktvendim Fq. nr.125/2025 datë 26.12.2025, hapi procedurë falimentimi kundër debitorit ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep. Procedura e hapur e falimentimit mbi debitorin nuk u zbatua dhe është mbyllur. Në aktvendim është përcaktuar, që Regjistri Qendror pas hyrjes në fuqi të këtij aktvendimi të fshijë debitorin nga regjistri tregtar.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli është i detyruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit të drejtorit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Pas Njoftimit të dorëzuar për inicim të procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr. 08-20 datë 22.1.2026, dhe me qëllim që Agjencia të verifikojë nëse ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep i përmbush kushtet minimale kuadrovice të përcaktuara në rregulloren e lartpërmendur, nëpërmjet SSPZAP ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ të punës së ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep. Në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ, nr. ark. 03-359/1 datë 29.1.2026, thuhet se më 29.1.2026, Agjencia ka siguruar të dhënat më të fundit nga APRMV-së, sipas të cilës numri i të punësuarve në personin juridik të lartpërmendur më 16.1.2026 është 1, ndërsa më 29.1.2026 është 1. Duke marrë parasysh sa më sipër, është konstatuar se transmetuesi nuk i përmbush kushtet minimale kuadrovice të përcaktuara në Rregullore dhe propozohet që Këshilli të miratojë vendim për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Lidhur me faktin nëse transmetuesi ka filluar me transmetim të programit televiziv, SMIÇP më 29.1.2026 ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ dhe drejtorit të

Agjencisë i dorëzoi Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. ynë. ark. 03-364/1 datë 29.1.2026. Në raport thuhet se gjatë mbikëqyrjes së kontrollit të punës së transmetuesit u konstatua se nuk transmeton program dhe propozohet që drejtori i Agjencisë t'i paraqesë propozim Këshillit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Prandaj, duke pasur parasysh faktin se ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit PA1 nr. 08-20 datë 20.1.2026 nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 62 paragrafi (6) të LShMAAV dhe nenit 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera (neni 82, paragrafi 1 nënparagrafi 2 të LShMAAV), drejtori i Agjencisë dorëzoi Propozim PA1 nr.08-43 datë 2.2.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të transmetuesit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë, në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafët 2 dhe 5 dhe neni 83 paragrafi (3) të LShMAAV, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr. 08-43 datë 2.2.2026 dhe Raporteve me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ, nr. ark. 03-359/1 datë 29.1.2026 dhe nr. ark. 03-364/1 datë 29.1.2026, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, nr. ark. 02.418/5.2026 datë 3.2.2026, miratoi Vendim me të cilin i hiqet leja PA1 nr. 08-141 datë 18.3.2019 për transmetim televiziv të ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.

Në pajtim me nenin 84 të LShMAAV, Vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi, zotëruesi i lejes ka të drejtë të paraqesë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Bazuar në sa më sipër, u miratua Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Zëvendëse e kryetarit të Këshillit,
mr. Zirjeta Jajaga d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi për heqje të lejes, ShTR TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi.